



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 116, Datë 22.07.2019**

**MBI**

**MIRATIMIN E “PROPOZIMIT TË TË GJITHË OST-VE PËR NJË METODOLOGJI  
TË PËRBASHKËT TË RRJETIT NË PËRPUTHJE ME NENIN 17 TË RREGULLORES  
SË KOMISIONIT (BE) 2015/1222 TË DATËS 24 KORRIK 2015, QË PËRCAKTON NJË  
UDHËZUES MBI ALOKIMIN E KAPACITETIT DHE MENAXHIMIN E  
KONGJESTIONEVE”.**

Në mbështetje të neneve 7, 16, 19, 23, 56, 65 dhe 67 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, nenit 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 Korrik 2015, neneve 58, 62, 64 dhe 104 të Kodit të Transmetimit të miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 186 dt. 10.11.2017 dhe nenit 26 të “Rregullave të Organizimit, Funkcionimit dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, si dhe duke mbajtur në konsideratë se Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sha, është anëtar me të drejta të plota i Rrjetit European të Operatorëve të Sistemeve të Transmetimit për Energjinë (European Network of Transmission System Operators for Electricity; (ENTSO-E), bordi i ERE në mbledhjen e tij të datës 22.07.2019 , mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorive Teknike në lidhje me propozimin e të gjithë OST-ve për një metodologji të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 Korrik 2015, që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestioneve,

**Konstatoi se :**

- Me vendimin e bordit nr. 88, datë 31.05.2019, ERE ka filluar procedurat për miratimin e “Propozimit të të gjithë OST-ve për një metodologji të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 Korrik 2015, që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestioneve”.
- “Propozimi i të gjithë OST-ve për një metodologji të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 Korrik 2015, që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestioneve.” , u përcoll për miratim nga OST sha me shkresën nr. 2035 Prot., datë 15.03.2019, protokolluar me tonën 228 Prot., datë 18.03.2019.

- Ky propozim vjen në zbatim të dispozitave të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, përkatësisht neneve 7, 16, 19, 23, 56 65 dhe 67, si dhe në përmbushje të detyrimeve të përcaktuara në Kodin e Transmetimit të miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s nr. 186 datë 10.11.2017, kapitulli IV në tërësi dhe nenit 64 të “Modeli i rrjetit per D-1 Dhe D” në veçanti; nenit 104 të “Modelet Individuale të Rrjetit, modelet e bashkuara të rrjetit dhe Analizat e sigurisë Operative”.
- Ky dokument është një propozim i përbashkët i hartuar nga të gjithë Operatorët e Sistemeve të Transmetimit në lidhje me krijimin e një metodologjie të modelit të përbashkët të rrjetit.
- Dokumenti i përbërë nga 24 nene me kërkesa specifike mbi modelin individual të rrjetit, skenaret, modelin e përbashkët të rrjetit, parametrat e cilësisë së MIRr (Modeli individual i rrjetit) dhe MPRr (Modeli i përbashkët i rrjetit ), blloqet baze të modelit, procesin e bashkimit të modeleve individuale, impaktin e pritur në objektivat e Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 Korrik 2015 dhe merr parasysh sigurinë operationale, optimizimin në llogaritjen dhe shpërndarjen e kapacitetit ndërzonal duke siguruar trajtim të drejtë dhe jo-diskriminues të pjesmarrësve të tregut si dhe duke rritur transparencën dhe besueshmërinë e informacionit.
- Në përputhje me vendimin e marrë nga European Network of Transmission System Operators for Electricity (ENTSO-E) dhe sipas udhëzimeve të përcjella, kjo metodologji do të zbatohet për të gjithë OST-të dhe interkoneksionet e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian të cilat do ta përcjellin për miratim tek autoritetet respektive rregullatore. OST-të nga një shtet jo-anëtar i Bashkimit Evropian inkurajohen gjithashtu që t’a përcjellin dokumentin pranë Autoritetit Rregullator duke siguruar një përktim të dokumentit së bashku me versionin në gjuhën angleze.
- ERE në vijim të Vendimit nr. 88, datë 31.05.2019, dhe në zbatim të nenit 26, pikat 3 dhe 5 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.06.2016, me shkresën nr. 32/28 Prot., datë 06.06.2019, publikoi për tre ditë me radhë në median e shkruar njoftimin për fillimin e kësaj procedure. Në përfundim të afatit të njoftuar, rezultoi që nuk kishtë asnjë koment apo opinion nga palët e interesuara
- Me shkresën nr. 228/2 Prot., datë 13.06.2019, ERE i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoritetit të Konkurrencës, për dhënie mendimi lidhur me propozimin e mësipërm.
- Në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo opinionëve rezultoi se, Autoriteti i Konkurrencës nëpërmjet shkresës me nr. 382/2 Prot., datë 02.07.2019, është shprehur se draft propozimi i të gjithë OST-ve për një metodologji të përbashkët të rrjetit në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 Korrik 2015, që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestionëve, nuk bie në kundërshtim me Ligjin Nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” i ndryshuar. .

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE,

## Vendosi:

1. Të miratojë “Propozimin e të gjithë OST-ve për një metodologji të përbashkët të rrjetit, në përputhje me nenin 17 të Rregullores së Komisionit (BE) 2015/1222 të datës 24 Korrik 2015, që përcakton një udhëzues mbi alokimin e kapacitetit dhe menaxhimin e kongjestionëve”.
2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie nga palët në interpretim të versionit shqip.
3. Drejtoria e Çështjeve Ligjore, të njoftojë palët e interesit për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletore Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

**KRYETARI I ERE**

**PETRIT AHMETI**

